

## **Takimi historik i vitit 1990 midis Presidentit të Shqipërisë Ramiz Alia dhe Kongresistëve Joe DioGuardi dhe Tom Lantos**

Kur fillova të shërbej njerëzit e zonës time zgjedhore në Westchester County, New York, më 4 janar 1985, pas një gare shumë të ashpër për të fituar një ulëse në Dhomën e Përfaqësuesve në SHBA, absolutisht nuk e kisha idenë se populli shqiptarë në Jugosllavi do të ketë nevojë për zërin tim në Uashington. Unë garova si një Kontabilist Publik i Certifikuar si italian i Amerikës me një “logjikë të shëndoshë” që të sjelli përgjegjësinë fiskale dhe llogaridhënien financiare në procesin buxhetor të Shteteve të Bashkuara, i cili kishte filluar të përjetonte deficite të mëdha vjetore dhe rritje të shpejtë të borxhit kombëtar. Unë kam lindur në Bronx më 20 shtator 1940, dhe jam rritur aty derisa në vitin 1957 prindërit e mi u shpërngulën në Westchester County, ku kam garuar për Kongres në vitin 1984 (pasi lash një karrierë njëzet e dy vjeçare si një CPA në atë që atëherë në Amerikë ishte një firmë më e madhe e kontabilitetit dhe e auditimit).

U deshën më pak se nëntë muaj të mandatit tim të parë dyvjeçar si Kongresist i SHBA që shqiptarët të zbulojnë se babai im ishte shqiptar etnik (si dhe shqiptarë amerikan), dhe unë të zbulojë se një popullatë e madhe shqiptare amerikane nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Malit të Zi, Lugina e Preshevës në Serbi, dhe Krahina Autonome e Jugosllavisë e Kosovës jetonte në dhe rreth Qarkut tim Zgjedhor. Të tjerat i takojnë së kaluarës. Unë isha në vend të duhur dhe në kohën e duhur për popullin shqiptarë të Jugosllavisë që vuante për një kohë të gjatë. Në vitin 1987 krimineli i luftës gjenocide Slllobodan Millosheviq u bë President i Serbisë dhe Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Dhe, jeta për popullin shqiptar, sidomos atij në Kosovë, më kurrë nuk ishte e njëjtë.

Tani, pas tridhjetë viteve, unë besoj se të gjithë shqiptarët e dinë se çka kam bërë se Anëtar i ri i Kongresit për të çliruar shqiptarët nga barbarizmi serbë, sidomos në Jugosllavi. Por për çka nuk ka mjaft njohuri është ajo çka ka bërë Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane kur Shirley Cloyes erdhi në skenë në vitin 1994, menjëherë pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Shirley, në atë kohë botuese e Lawrence Hill Books, e specializuar në politikën ndërkombëtare, u bë partnere e ime në kërkimin tonë për drejtësi për të gjithë shqiptarët, dhe kjo çoi deri te arrestimi, gjykimi për krime, dhe vdekje të Slllobodan Millosheviqit në Hagë për krime kundër njerëzimit në vitin 2002 dhe pavarësi të Kosovës në vitin 2008. (Shirley dhe unë jemi martuar në vitin 1998, dhe më 28 qershor 2018 do të festojmë përvjetorin tonë të 20-të.)

Të kthehem në vitin 1990, ku është një pjesë e rëndësishme e historisë që tregon se çka kam qenë në gjendje të arrij në vitet e hershme të Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, gjë që ende është kryesisht e panjohur. Dhe, kjo tani do të ndryshojë, pasi që rishtas Shirley ka qenë në gjendje që të merr nga Arkiva Kombëtare e Shqipërisë transkriptin e shkruar zyrtar (nga arkivat e Partisë Komuniste të Shqipërisë) të takimit që zgjati dy orë e gjysmë, të cilin e kishim Kongresisti i ndjerë Tom Lantos dhe unë me Presidentin e Shqipërisë Ramiz Alia më 30 maj 1990. Ky takim ka rezultuar me dy zhvillime të rëndësishme: e para, njohja diplomatike e Shqipërisë pa kushte paraprake nga Departamenti i Shtetit të SHBA nën Presidentin George H. W. Bush brenda një muaji pasi që Tom Lantos dhe unë u kthyem prej Shqipërisë; dhe e dyta, zbulimi se të gjithë çifutët në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore kanë shpëtuar nga Holokausti Nazist.

Kjo e fundit ishte si rezultat i veprimeve pro-aktive dhe skajshmërisht të rrezikshme të popullit shqiptar dhe qeverisë së tyre për të shpëtuar çdo familje çifute që jetonte në Shqipëri me shekuj dhe mijëra të tjerë që kanë mundur të iknin nga Evropa Perëndimore dhe Jugosllavia e okupuar nga nazistët (me ndihmën e shqiptarëve aty) në Shqipëri, e cila ishte e okupuar nga fashistët italianë derisa Italia e lëshoi Aksin në vitin 1943 dhe në vend të tyre erdhën nazistët e Gjermanisë.

Më 30 maj 1990, Presidenti i Kuvendit Popullor të Shqipërisë, Ramiz Alia, ishte nikoqir i takimit në Tiranë me Kongresistët Tom Lantos, Anëtarin e rëndësishëm të Komisionit për Punë të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve të SHBA dhe Kryesuesin e delegacionit permanent të qeverisë së SHBA në Parlamentin Evropian, si dhe Kongresistin e dikurshëm Joe DioGuardi. Ajo që vijon janë ekstraktet më të rëndësishme nga takimi historik në mes të Presidentit Ramiz Alia dhe Kongresistëve Tom Lantos dhe Joe DioGuardi.

**Ramiz Alia** e filloi seancën e gjatë dy orë e gjysmë duke thënë:

“Kam dëgjuar për juve personalisht, Z. Lantos, dhe për Joe DioGuardi. Është kënaqësi të takohem me ju. Shqipëria dhe Amerika kanë një gjë të madhe midis tyre: Në Amerikë ka shumë shqiptarë. Vëllezërit dhe motrat tona kanë gjet aty një atdhe të madh, dhe ajo që ka rëndësi është se ata i kanë ruajtur lidhjet me atdheun e tyre. Ata kanë luftuar dhe ndihmuar për liri dhe pavarësinë e popullit shqiptar. Amerika iu ka ndihmuar atyre, dhe Shqipëria i ka pranuar si bijtë e saj. Ata kanë mbajtur dhe ende mbajnë kontaktet me vendin e tyre. Kjo është një gjë me shumë rëndësi, që, me siguri, siç ka ndihmuar në të kaluarën, do të ndihmojë edhe në të ardhmen për të forcuar marrëdhëniet e miqësisë midis popullit shqiptar dhe popullit amerikan. Në Shqipëri, Amerika ka një emër të mirë, dhe edhe kjo është meritë e shqiptarëve të Amerikës, por edhe të amerikanëve të mëdhenj që kanë punuar dhe vepruar për Shqipërinë. Kam parasysh Presidentin e SHBA Woodrow Wilson, i cili ka qenë kundër copëtimit të Shqipërisë. Për ne shqiptarët, Z. Lantos, çështja e lirisë dhe pavarësisë është mbi të gjitha. Me siguri, Z. DioGuardi është gjak shqiptar dhe e di ç’ është besa shqiptare. Prandaj kujto që respekton popullin shqiptar, respekton lirinë dhe pavarësinë e tij. Ne shqiptarët i japim zemrën.”

**Kongresisti Lantos** u përgjigj ndaj hapjes së butë dhe të mirësjellshme të Presidentit Alia në takimin tonë:

“Miku im DioGuardi kthehet në Shqipëri pas 500 vjetësh dhe kthehet si një bir i vërtetë i saj, krenar për faktin që është me origjinë shqiptare. Ai është ndoshta shembull më i shquar, Z. President, i suksesit jashtëzakonisht të madh të popullit shqiptar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të gjithë shqiptarët kërkojnë mundësi të barabarta, qofshin ata në New York ose Tirana apo në Kosovë. Ata nuk kërkojnë privilegje të veçanta, por duan atë që ne e quajmë një fushë të niveluar mirë. Nuk duan të jenë të diskriminuar dhe, kur të kenë një fushë loje të niveluar mirë, një djalë shqiptar bëhet biznesmen i suksesshëm dhe një partner në një nga firmat ndërkombëtare më të respektuara të kontabilitetit, Anëtar i Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ai, Joe DioGuardi, gjen se dëshiron t’i dedikojë veten e vet për zgjerimin e

marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për këtë unë e respektoj.

“Gjithnjë kam dashur të vij në Shqipëri. Me gruan jam martuar që prej 40 vjetësh, por e kam njohur më përpara dhe ajo mund të dëshmojë që gjatë gjithë këtyre viteve unë kam dashur të vij në Shqipëri. Prandaj ju falënderoj juve personalisht që na e bëtë të mundur ardhjen këtu.”

(Duhet të vërehet se Lantos më herët më tha në besim se ai ka lexuar së pari për Skënderbeun dhe partnerin e tij, Janos Hunyadi, të cilët kërkonin lirinë nga turqit Otoman në shekullin e 15-të, kur ishte djalë i vogël në shtetin e tij të lindjes në Hungari, dhe i tha këtë Ramiz Alisë.)

### **Ramiz Alia u përgjigj:**

“Ne e kemi për nder të madh si popull që në tërë historinë tonë kombëtare që është 2-3 mijëvjeçare, asnjëherë populli shqiptar nuk ka shkuar të luftojë kundër një populli tjetër. Kurrë nuk ka ndodhur kjo, as kundër grekëve me të cilët kemi mijëra vjet pranë, as kundër sllavëve, as nga ana tjetër e detit. Kemi dalë jashtë kufijve vetëm për një arsye: për të ndihmuar popujt vëllezër. Meqenëse jemi në historinë e Skënderbeut, Skënderbeu shkoi të ndihmojë Alfonsin e Napolit, por jo për të pushtuar tokat e Italisë. Shqiptarët kanë marrë pjesë në Revolucionin Grek të 1928-ës për pavarësinë e popullit grek. Edhe në Luftën e Dytë Botërore, edhe unë personalisht me një divizion partizan kam kaluar kufirin jugosllav, kam luftuar në Kosovë, në Sanxhak, deri në Sarajevë për çlirimin e popujve të Jugosllavisë bashkë me partizanët jugosllavë. Prandaj jemi krenarë se kurrë ndonjëherë nuk kemi shkuar të luftojmë kundër popujve tjerë. Na i duam dhe i çmojmë lirinë dhe pavarësinë tonë. Prandaj dimë dhe të nderojmë lirinë dhe pavarësinë e të tjerëve. Na pëlqen sinqeriteti, na pëlqen të jemi të hapur, sepse vetëm në këtë mënyrë të tjerët na kuptojnë dhe i kuptojmë. Historia jonë si histori e vjetër na ka mësuar shumë gjëra, po një gjë të madhe nuk e harrojmë kurrë, që pa liri e pavarësi, asgjë nuk ka.”

### **Alia vazhdoi:**

“Të shkojmë tek Skënderbeu edhe një herë? Skënderbeu erdhi në Shqipëri andej nga erdhët ju. U nda me Huniadin në Fushë Kosovë, erdhi nga Kukësi dhe u fut në Shqipëri. Çfarë bëri sapo erdhi këtu? Mblodhi të gjithë princat shqiptarë në Lezhë. Ju kaluat andej. Ai mblodhi tërë princat shqiptarë dhe vendosi lidhjen e parë shqiptare për të rezistuar kundër turqve. Pse e them këtë fakt? Është në traditën tonë që shqiptarët duhet të jenë të bashkuar se po të jenë të ndarë uniteti kombëtar do të dobësohet. Duam që popullin ta kemi të bashkuar, se po nuk qe i bashkuar, ne jemi një vend i vogël, të ndarë në 5 pjesë nuk jetojmë dot.

“Sot në botë shtrohen shumë probleme, të cilat i shikojmë në prizmin e interesit të Shqipërisë. Zhvillimin e ndjekim duke pasur parasysh realitetin shqiptar. Nuk jemi konservatorë, në kuptim in e njerëzve difidentë ndaj së resë, difidentë ndaj përparimit. Si mund të akuzohemi se jemi kundër progresit, ne që nga analfabetizmi, u ngritëm në Akademinë e Shkencave, ne që nga

analfabetizmi, 75 për qind të rinisë e kemi në shkollat e mesme? Do të ishte një absurditet. Po, fatkeqësisht, Shqipërinë para nuk e njohin. Për këtë mund të kemi faj edhe ne.”

(Pasi që edhe Lantos foli për arritjet e mëdha të Shteteve të Bashkuara, Ramiz Alia e theksoi kulturën e lartë të popullit shqiptar, e cila i mundësoi që të rezistojë të gjithë okupatorët të tokave shqiptare dhe tentimet e tyre për asimilim.)

**Ramiz Alia:** “Populli shqiptar nuk është popull pa kulturë. Ishte pa shkollë, po jo pa kulturë, këto janë dy koncepte të ndryshme. Po të ishte ky popull pa kulturë, 500 vjet nën okupacionin turk do të ishte asimiluar se ishte popull i vogël. Pse nuk u asimilua? Pikërisht se kishte një kulturë më të lartë se okupatorët. Okupatori nuk solli kulturë më të lartë. Logjika është e thjeshtë. Kultura shqiptare rezistoi, gjuha shqipe rezistoi. Kjo do të thotë që kishte një strukturë më të organizuar në të folur, në sintaksën e saj etj. etj.

“Ju patë muzetë etnografik e muze të tjerë. Patë sot në Berat pikturat dhe vepra tjera të artit në kishat. Ato pasqyrojnë kulturën e popullit, edukatën dhe vlerat e tij shpirtërore. Po mirë, ne që luftojmë për këtë popull, ta fshijmë këtë kulturë? Po të bënim këtë ne do të ishim kriminelë, do të ishim antikombëtarë. Por për të ruajtur këtë kulturë, jemi mbyllur, nga ata që do të na ndryshonin.

“Na thonë shumë miq zhvilloni turizmin se do të fitoni para. E kam të qartë që turizmi është një biznes me rëndësi. A mund të bëjmë më shumë? Jam dakord që duhet menduar, por nuk do të jem dakord që turizmi të bëhet shkas që në Shqipëri të vij droga, të vij prostitucioni, SIDA, të futet terrorizmi dhe fenomene të tjera, të cilat nuk njihen tek ne.

“Mesazhi im do të ishte që Shqipëria është e gatshme të vendosë marrëdhëniet diplomatike me Shtete e Bashkuara të Amerikës. Ne nuk kemi asnjë pengesë për këtë, bile ambasadorin tonë në Kombet e Bashkuara do ta ngarkojmë që me t’u kthyer atje të marrë kontakt me zyrtarë amerikanë për të diskutuar mbi këtë çështje sepse janë problemet e procedurave burokratike. Unë nuk besoj të ketë ndonjë problem parimor që të pengojë.”

(Kongresisti Lantos u pajtua me Ramiz Alinë se ishte koha e duhur që të vendosen marrëdhëniet diplomatike.)

### **Alia u përgjigj:**

“Edhe ne jemi të të njëjtit mendim. Edhe neve na intereson, bile nga një pikëpamje jemi më të interesuar. Ne jemi një vend i vogël, Amerika është një vend i madh, ne jemi një vend i varfër, Amerika është një vend i pasur. Kështu që nga çdo pikëpamje Shqipëria mundet të ketë interesa më shumë se sa ka Amerika në Shqipëri.”

**Lantos pastaj tha:**

“Dhe nuk do të ketë, jam i bindur për këtë, asnjë lloj kushti politik. Do të jenë marrëdhënie të mira, qoftë për Shqipërinë, qoftë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat do t’u ofrohen këtyre marrëdhënieve e do t’i shikojnë si të barabarta.”

**Dhe Ramiz Alia u përgjigj:**

“Shumë mirë. E vërteta është dhe rëndësi ka që marrëdhëniet midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë të vendosen mbi baza të sinqerta, të vendosen mbi bazat e besimit reciprok, të mosdërrhyrjes në punët e brendshme, pa kushte politike sepse kjo bën miqësi popujsh. Ne nuk kemi politikë me dy faqe. Po kalojë në një temë tjetër, tek jugosllavët. Mos ju lodha.”

**Tom Lantos u përgjigj:**

“Aspak, ne jemi shumë të entuziazmuar. Përpara se të kaloni në këtë çështje [të Jugosllavisë], desha të them diçka. Ju lutem shumë më besoni se ajo që ju them del nga zemra. Ju jeni nga udhëheqësit më të dashur karismatik me të cilët jam takuar. Kam takuar shumë udhëheqës në botë që nga Kina, Japonia, Anglia etj. Jam shumë i gëzuar që nuk ju kam konkurrent në fushatën elektorale kundër karriges sime në Kongresin amerikan, se do të humbisja. “

**Ramiz Ali u përgjigj:**

“Dakord! Për mua është kënaqësi e veçantë që po bisedoj me ju, se po shikoj që sinqeritetit tim po i përgjigjeni me sinqeritet.”

“Tani për Jugosllavinë desha të theksoj një gjë që ta keni të qartë. Ne kemi interes që Jugosllavia të jetë e bashkuar. Ne nisemi nga interesi kombëtar. Unë thashë që kryesorja për ne është çështja e lirisë dhe e pavarësisë. Ky është këndi i vështimit dhe nuk ka as kënd stalinist, as tjetër. Nga ky kënd Jugosllavia na intereson të jetë kjo që është, federative, konfederative, kjo është puna e tyre, por jo e çarë.”

**Tom Lantos:** “Jam plotësisht dakord. Kjo është edhe në interesin tonë. Dhe gjithnjë ua themi këtë. Ua thashë edhe në Kosovë përpara disa ditësh (në Hotel Grand në Prishtinë).”

**Ramiz Alia:** “Sigurisht problemi i Kosovës është me rëndësi të madhe. Ne jemi 3 milion, 2 milion e gjysmë janë andej në vazhdim me Shqipërinë, nuk futet në mes askush. Por nuk e kemi shtruar dhe as nuk e shtrojmë problemin e bashkimit, jo. Ne shtrojmë problemin që Kosova duhet të ketë të gjitha të drejtat si gjithë kombet e Jugosllavisë. Në një shtet shumëkombësh si Jugosllavia, Kosova duhet të jetë pjesë e tërës. Ajo duhet të ketë hapësirë veprimi si komb në tërë hapësirën jugosllave. Prandaj politika jonë është që Kosova të ketë vendin e vet në

federatën jugosllave. Ne na intereson një Jugosllavi demokratike, bile do të thosha Ballkanit i intereson një Jugosllavi demokratike. Një Jugosllavi jo demokratike përbën një rrezik për tërë Ballkanin.

“Z. Lantos, unë si President i Republikës përgjigjem për popullin tim, për lirinë, për pavarësinë, po kur unë di që në Kosovë në kufirin tonë janë 15,000 ushtarë me tanke, me avionë, me helikopterë, me topa dhe që vazhdimisht bëjnë stërvitje në kufijtë tanë a mund të jem i qetë?”

**Ramiz Alia:** “Një libër shqiptar nuk shkon matanë, një libër që andej nuk vjen këtej. Familjet shqiptare në këtë anë dhe në atë anë të kufirit nuk komunikojnë. Nuk lenë asnjë njeri të shkojë matanë. Jeni ju të parët mbas kaq vitesh që kaluat kufirin në atë pikë. Ajo pikë kufiri ka mbetur e vdekur.”

**Tom Lantos:** “Kjo është çmenduri.”

(Në këtë rrethanë, unë vendosa që të futem në këtë shkëmbim të mrekullueshëm të mendimit mbi Jugosllavinë dhe Kosovën.)

**Joe DioGuardi:** “Pasi kemi studiuar për shumë vite çështjen e Kosovës dhe Shqipërisë, duke dëgjuar lloj - lloj mendimesh, një mendim që duhet të kemi parasysht Zoti President dhe jam i bindur që ju e dini, tani që ju po ndërtoni këtë urë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, jugosllavët po bëhen shumë nervoz. Kjo nuk është vetëm ngjarje e kohëve të fundit. Kjo lidhet me imazhe jo të drejta që janë krijuar ndonjëherë e që mund të krijohen edhe në të ardhmen kundër Shqipërisë.”

**Ramiz Alia:** “Kjo që thatë Z. DioGuardi lidhet pikërisht me atë imazh që është përpjekur Jugosllavia të krijojë për Shqipërinë si një vend i mbyllur—stalinist, ortodoks etj. Marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara, politika e jonë e inkludimit në problemet e Evropës etj., ardhja e juaj këtu shkojnë kundër këtij imazhi. Sidoqoftë, do të përpiqemi të kemi marrëdhënie të mira me Jugosllavinë.

“Ne shqiptarët njihemi si inatçi, por në politikë nuk jemi të tillë. Në politikë duhet pasur mendjen e freskët. Ne nuk mbajmë inat, jo. Ne mendojmë që interesat e popullit tonë, të shqiptarëve të Shqipërisë, edhe të Kosovës, janë që marrëdhëniet tona me Jugosllavinë të jenë të mira, sepse nga marrëdhëniet tona të mira edhe Kosova do të ketë fitim. Por, unë ju them një gjë, që kurrë Shqipëria nuk do të ketë marrëdhënie të mira me Jugosllavinë në kurriz të Kosovës. Kurrë nuk do ta bëjmë këtë.”

**Ramiz Alia vazhdoi:** “Thash që do të përpiqemi të kemi marrëdhënie me Jugosllavinë. Kemi kërkuar të kemi kontakte me ta. Mundet të vijë ministri Jashtëm i Jugosllavisë tek ne. Edhe unë jam i mendjes që mirë është të vijë, por vështirë do ta kem të bisedoj me te. Për s’arsye? Sepse nuk ka gjë në dorë. Kjo është situata në Jugosllavi, por prapë nuk jemi ne që do ta rregullojmë

gjendjen atje, u përket popujve të Jugosllavisë. Ne do të respektojmë dëshirat dhe vullnetin e popullit jugosllav, e do të bëjmë të tëra përpjekjet që me të vërtetë të ketë marrëdhënie miqësie midis popullit tonë dhe popujve të Jugosllavisë.

“Këtë politikë e ndjekim edhe me Greqinë, duam të kemi marrëdhënie të mira. Marrëdhëniet me ta janë herë mirë, herë keq, ndryshojnë sipas temperaturës. Por mendoj që nuk është ndonjë problem serioz.”

**Tom Lantos përgjigjet:** “Unë besoj se duke pasur një ambasadë amerikane në Tiranë e tërë situata do të jetë normale. Situata e tanishme nuk është normale. Ka ambasador amerikan në Beograd, në Sofje, në Athinë, në Bukuresht, kurse këtu nuk ka. Nuk ka kuptim. Unë besoj se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të jenë në gjendje të kryejnë funksionin mjaft të dobishëm për ti mbajtur marrëdhëniet në mënyrë harmonike. Vërtetë kështu mendoj.”

“Unë, zoti President, do të bëj gjithçka të mundur të ju tregoj kolegëve të mi në Kongres që ata duhet të vijnë për vizitë këtu. Unë mendoj se sa më shumë vizitor që keni nga Kongresi Amerikan aq më shumë miq do të ketë Shqipëria. Për këtë jam i bindur.”

**Ramiz Alia u përgjigj:** “Ju faleminderit. Unë ju thash se Shqipëria, në tërë historinë tonë, ka pasur nevojë për miq. Ne themi se në kohërat më të këqija, aleatët më të mëdhenj i kemi pasur malet.”

(Duke e ndjerë se takimit po i vjen fundi, e kam ditur se është e rëndësishme që Presidenti Alia, të din pikë vështrimin tim për Millosheviqin dhe historinë e bukur të shqiptarëve të Italisë Jugore pasi që Otomanët turk ia dolën ta okuponin Shqipërinë më 1488.)

**Joseph DioGuardi:** “Më lejoni të flas edhe për një çështje tjetër, dhe konkretisht për qëndrimin e Jugosllavisë. Para pak kohe Millosheviqi mbajti një fjalim ku thoshte se Amerika ndërhynte në punët e tyre të brendshme, por ai është edhe shumë arrogant ndaj Shqipërisë. Serbët njohin një Shqipëri, atë që e krijoi Enver Hoxha, pra një Shqipëri të mbyllur. Ne jemi të sigurt se serbët gjithnjë kanë krijuar tensione nga më të ndryshmet. Nuk e di nëse Departamenti i Shtetit është në dijeni për të gjitha këto probleme të krijuara. Është me rëndësi të njihet historia e kësaj zone. Në çdo hap që mund të ndërmerret duhet pasur parasysh se ky është Ballkani dhe jo Ballkani i “ballkanizuar”. Pika e dytë është që ju e përmendët se 500 vjet turqit nuk kanë qenë në gjendje t’i asimilojnë shqiptarët. As italianët nuk e kanë bërë këtë. Sot ka vetëm në regjionin e Kalabrisë të Italisë jugore 38 katunde shqiptare. Baba im është nga katundi Greci, pak më në veri ku shqipja gjithashtu është gjuha origjinale. Kur fëmija lindë në fshatin e babait tim, ata e çojnë atë lartë me fytyrë drejtë Shqipërisë ndonëse kanë kaluar 500 vjet prejse shqiptarët kaluan në gadishullin italian.

“Unë kam lindur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku shkoi familja ime më 1929. Babai im nuk ishte në gjendje të përballonte kushtet e tmerrshme ekonomike në Italinë e atyre viteve. Amerika na dha rastin, edhe familjes sime, edhe familjes së Kongresistit Lantos që të imigrojmë dhe sot këtu ë përpiqemi që të ndihmojmë më tutje popullin tonë në Evropë.

“Unë besoj se ne kemi ruajtur traditat, që ju i përmendët, për të cilat më ka folur edhe babai. Pra po të isha thjeshtë i interesuar për publicitet unë do të vij vetëm. (E dini se kam pasur disa thirrje të vij vetëm në këtë udhëtim, por unë kam dashur të sigurohem se kur të vij në Shqipëri, arritja ime të ketë kuptimin e vërtetë për popullin e babait tim këtu dhe për Shqipërinë, Z. President.)

“Unë e kam Kongresistin Tom Lantos-in mik shumë të mirë, i cili ka qëndruar pranë meje për çështjen shqiptare secilën ditë. Dhe në atë këmbënguljen time, si një “Shkodran” (dhe nuk e di nëse babai im ishte vërtetë nga Shkodra, pasi që nuk kam asnjë dokument të shekullit 15-të kur shqiptarët ikën në Itali), kam ditur se ka për të ardhur koha për Kongresistin Lantos dhe mua që të vijmë së bashku. Nuk kam dashur të tradhetoj fjalën e dhënë popullit shqiptar. Por, unë gjithashtu nuk kam dashur të ju marr kohën e juaj sikur të isha ardhur vetëm dhe të mos arritja asgjë të rëndësishme. Kurse tani ka ardhur koha që kur të kthehemi do të bëjmë diçka me efekt të madh. Unë nuk kam ardhur që emri im të del në gazetë, por përkundrazi, qëllimi im është që të bëj diçka të rëndësishme për Shqipërinë.

“Edhe zoti Lantosh është njeri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës që respektohet më shumë në Evropë, por edhe nga komuniteti çifut në tërë botën, meqenëse ai është çifut dhe shpëtoi nga holokausti i nazistëve. Por disa të tjerë e njohin që është edhe hungarez, pasi që e lëshoi Hungarinë për të ardhur në SHBA.”

**Ramiz Alia:** “Ju faleminderit që ma kujtuat punën e çifutëve. Nuk e di se a keni dijeni se Shqipëria është i vetmi vend në Evropë i cili nuk e ka dorëzuar asnjë çifut gjermanëve.”

**Tom Lantos:** “Nuk e kam ditë, dhe këtë dhe do të bëjmë botërisht të ditur.”

**Ramiz Alia:** “Unë po ju them, dhe jam dëshmitar personal, se në kohën e Luftës së Dytë Botërore kur gjermanët hynë në Jugosllavi, shumë çifutë erdhën nga Jugosllavia në Shqipëri. Gjermanët në Jugosllavi kanë ardhur më 1940, kurse në Shqipëri ishin italianët. Gjermanët erdhën mbasi Italia kapitulloi, dhe detyra e parë ishte që t’i kërkojnë çifutët.”

“Unë e kam njohur para Luftës një mjek çifut në Tiranë. Kur u ktheva nga lufta e pashë përsëri në Tiranë. Morra vesh se e kishin marr fshatarët dhe e kishin fshehur, dhe gjermanët me gjithë operacionet e tyre nuk kanë mund ta gjejnë.”

**Tom Lantos:** “Jam shumë i lumtur që po dëgjoj këtë (për mbijetesën e çifutëve në Shqipëri). Kam dëgjuar mjaft për këtë, por jam shumë i lumtur që këtë ma thoni ju.”



**Ramiz Alia:** “Gjermanët tek ne kanë bërë terror të madh. 3% e popullatës është vrarë. Kjo është përqindje e madhe në Evropë.

Gjatë luftës kam qenë atje ku ishit ju, në Berat. Kam lindur në Shkodër, rritë në Tiranë. Në Tiranë kam mbaruar edhe shkollën e mesme, por në kohën e luftës kam qenë në Berat. Mbaj mend mirë që në shtator të vitit 1943 në Berat kishte shumë çifutë të ardhur nga Jugosllavia. Kur gjermanët hynë në Berat, tërë çifutët erdhën në zonën e çliruar, në Skrapar, në atë malin që keni parë rishtazi, në Tomor. Atje ishim ne partizanët. Ata qëndruan atje deri në fund të luftës. Pasi mbaroi lufta u kthyen në Jugosllavi në shtëpitë e tyre. Një letër që ata i kanë dërguar Shokut Enver Hoxha është botuar në shtypin tonë në atë kohë. Ata falënderonin qeverinë shqiptare duke theksuar se Shqipëria është vendi i vetëm ku asnjë çifut nuk u është dorëzuar gjermanëve.”

**Tom Lantos:** “Unë personalisht do të kujdesem që kjo histori të bëhet e njohur shumë më tepër.”

**Ramiz Alia:** “Është një karakteristikë e popullit shqiptar. A duhet t’i harrojmë ato? Jo, se po që se e bëjmë këtë, do të bënim gabim.

“ Ne, thash, e ndjekim rrugën tonë. Shoqëria që duam ta ndërtojmë mbështetet në bindjet tona, por mbi këto baza, duke respektuar këto zakone, këtë traditë. Kjo traditë kombëtare është si lagështia që u vjen rrënjëve të bimëve dhe zhvillon degët, gjethet dhe lulet e saj. Këtë rrugë ndjekim ne. Këta jemi ne shqiptarët.

“Mbase e pikturova me ngjyra shumë të bukura, por më nxiti dhe Joe DioGuardi, më bëri pak nacionalist.”

**Joe DioGuardi:** “Dua të ju them se është e rëndësishme (duke rrezikuar të bëj analogji që mund të duket jo modeste), duke e krahasuar kthimin tim në Amerikë me Skënderbeun. Ju thatë se para 500 vjetëve Skënderbeu mblodhi të gjithë princat shqiptar kur kishte problemin e turqve-kurse unë jam munduar t’i bashkoj “Princat Shqiptarë” në Amerikë. Është lobi i Shqiptarëve të cilin unë e kam themeluar, Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane, problemi i parë i së cilës është Kosova. Dua të ju prezantoj një kopje të gazetës Shqiptaro-Amerikane, *Shqiponja Shqiptare*, të cilën e kam krijuar me “Princat e rinj shqiptarë” në Amerikë të cilët dëshirojnë të ndihmojnë zgjidhjen e problemit të Kosovës.

**Ramiz Alia:** “Ju faleminderit shumë. Ju më dolët para me çështje shumë të rëndësishme. Unë pikërisht doja të ju përsëndes dhe të ju falënderoj për atë punë që bëni ju, dhe që e bën e gjithë Liga Qytetare Shqiptaro Amerikane në Uashington, DC, për çështjen e Kosovës. Është çështje fisnike ti dalësh zot një populli që lufton për të drejtat e veta. Është nderë për secilin qytetar. Dhe natyrisht, kur takohemi me ju, unë e di kontributin që e jep zoti Lantos në këtë çështje, që nuk bën asgjë tjetër pos të ngjallë respektin tim të lartë për humanizmin tuaj, për shpirtin tuaj të lirisë dhe demokracisë, të pavarësisë, të respektit për popujt që luftojnë për të ardhmen e tyre. Ne i

kemi vëllezër kosovarët dhe atë punë që e bëni për ta është njësoj sikur e bëni edhe për ne. Është e njëjta gjë.”